

URDHËR
Nr. 350, datë 27.6.2014

PËR DELEGIM KOMPETENCE

Në mbështetje të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës, të ligjit nr. 9000, “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave” të nenit 7, pika 2, të ligjit nr. 8678, datë 14.5.2001, “Për organizimin dhe funksionimin e Ministrisë së Drejtësisë”, të ndryshuar, të nenit 27 të ligjit nr. 8485, datë 12.5.1999, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Delegimin e kompetencave të titullarit të Ministrisë së Drejtësisë, nga data 29.6.2014 deri në datën 3.7.2014, zëvendësministrave të Drejtësisë z.Arben Isaraj dhe z. Idlir Peçi, brenda fushës së kompetencave të deleguara me urdhrin nr. 7, datë 8.1.2014, të Ministrit të Drejtësisë.
2. Ngarkohen zëvendësministrat e Drejtësisë z.Arben Isaraj dhe z.Idlir Peçi për zbatimin e këtij urdhri.
3. Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I DREJTËSISË
Nasip Naço